

**AKT-THEMELIMI**  
**i**  
**SHOQERISE TREGTARE “BAJRAMI -N “ SH.P.K.**

Ne baze te nenit 2 te ligjit nr.7512, date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarur te privatizimit" dhe ne zbatim me ligjin nr.7638, date 19.10.1992, "Per shoqerite tregtare" behet themelimi i shoqerise "**BAJRAMI -N** " sh.p.k me seli prane Parkut te mallrave Elbasan , e mbeshtetur ne statutin e kesaj shoqerie me ortak te vetem Z. Nazif Bajrami , shtetas shqiptar .

**VENDOS**

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**BAJRAMI -N** " SH.P.K. me kushtet e meposhtme:

**NENI 1**

Themeluesi ne cilesine e ortakut te vetem krijon shoqerine tregtare "**BAJRAMI -N** " SH.P.K. me statusin juridik te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", me mjetet e veta financiare dhe duke paguar kontributin ne para.

**NENI 2**

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**BAJRAMI -N** " sh.p.k. emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.

Ajo ka vulen e saj, ne te cilin eshte shkruar "**BAJRAMI -N** " sh.p.k. Elbasan- Albania.

**NENI 4**

Shoqeria e ka seline e saj prane Parkut te mallrave , *Elbasan*.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.



## NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet mbi 10 vjet, me perjashtim te rastit kur ortaku vendos nje prishje te parakoshme te saj ose vendos per shtytje te metejshme.

## NENI 6

Objekti i veprimtarise do te jetë :

**“ Eksport –import i te gjitha llojeve te mallrave , industriale , ushqimore , materialeve te ndertimit , tregtim i tyre me shumice dhe me pakice , bilardo dhe lojera elektronike .”**

## NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

## NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte 100.000 leke. Ky kapital ndahet ne 100 kuota te barabarta me nga 1000 leke secila.

Ortaku i vetem Z.Nazif Bajrami zoteron 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

## NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte perjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

## NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga nje keshill administrativ. Themeluesi me vendim te veçante do te emeroje dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin", si dhe do te krijoje fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti finanziar ne baze te nenit 214 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakut te vetem.



## NENI 11

Percaktimi i struktura organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj, behen nga keshilli administrativ.

Mardheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

## NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

**THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE  
“BAJRAMI -N “ SH.P.K**

*Nazif Bajrami* Nazif Bajrami  





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE  
Nr. /355 Rep  
Nr 223 Kol

Elbasan me /7/02/-2000

### VERTETIM

Une noterja Anila Batalli vertetoj se perpara meje eshte paraqitur : Z.Nazif Bajrami , i  
biri i Pashos , i dtl 01-11-19697 , lindur dhe banuese ne Elbasan , lagja ' Konferanca  
e Labinotit " i identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr : 1076105 , i  
cili me rezultoi madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike dhe deklaroi se ka  
nenshkruar pa asnje hezitim kerkesen e mesiperme ne pranine time si notere.

Ky akt u nenshkrua rregullisht edhe nga une Noterja .



**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "BAJRAMI -N" SH.P.K.**

Shoqeria tregtare "BAJRAMI -N" SH.P.K krijohet ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ".

**KREU I**  
**Dispozita te per gjithshme**

**NENI I**

Shoqeria "BAJRAMI -N" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar. Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtar dhe ne Zyren e Tatimeve.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e themelimit (Akti i Themelimit dhe Statuti )

**NENI 2**

Shoqeria "BAJRAMI -N" SH.P.K eshte nje shoqeri me per gjegjesi te kufizuar me seli prane parkut te mallrave *Elbasan*.

Shoqeria mund te cele zyra perfaqesie,dege ose filiale ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj .

**NENI 3**

Shoqeria "BAJRAMI -N" sh.p.k parashikohet te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe prej me shume se 10 vjetesh, me perjashtim te rastit kur ortaku vendos prishjen e saj para ketij afati ose kur vendos shtyrjen e veprimtarise se saj tej afatit te mesiperm .

**NENI 4**

Emertimi i shoqerise eshte "BAJRAMI -N" SH.P.K.

Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korespondence ne faturat,ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala " sh.p.k " ose " Shoqeri tregtare me per gjegjesi te kufizuar" nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

**KREU II**  
**Objekti i veprimtarise**

## NENI 5

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jetë :

“ Eksport -import i te gjitha llojeve te mallrave , industriale , ushqimore , materialeve te ndertimit , tregtim i tyre me shumice dhe me pakice , bilardo dhe lojera elektronike .”

## NENI 6

Themeluesi i shoqerise rezervon te drejten te modifikoje objektin e veprimtarise ne cdo kohe.

### KREU III Kapitali themeltar

## NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte 100.000 (njeqindemije leke ) leke.Ky kapital ndahet ne 100 kuota te barabarta me nga 1.000 leke secila.

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie Z. Nazif Bajrami zoteron 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

### KREU IV

## NENI 8

Ortaku ushtron kompetencat qe i jane caktuar , ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ". Ajo merr vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj .

## NENI 9

Vendimet ne emer te ortakut merren sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.Ortaku merr vendime per ceshtjet e meposhtme:

- Miraton strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise.
- Administratori i vetem i shoqerise emerohet Z.Nazif Bajrami .
- Ndryshon e modifikon statutin e shoqerise , kapitalin themeltar e objektin veprimtarise se shoqerise , si dhe ndryshimin e formes juridike te shoqerise.
- Miraton llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.
- Vendos per prishjen e shoqerise para afatit te percaktuar ne Aktin e Themelimit ose per kalimin e ketij afati.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Riorganizimin , mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likuidimin e saj .
- Orientimet ne baze te te cilave do te drejtoje veprimet shoqeria , e do te caktoje preferencat e politikes se saj ekonomike e komerciale .

- Ndermarrjen e aktiviteteve te reja afariste .
- Dhenien per peng ose hipoteke apo siguri tjeter te ngashme.

#### NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne neni 50 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare ".

Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise .

Administratori perfaqeson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te sase pale te tjera , me banka,shoqeri transporti, e tjere.

E drejta e firmes per veprimet e kryera nga shoqeria dhe qe ndodhen brenda kompetencave te administratorit sipas ketij neni i takon ketij te fundit.

#### NENI 11

Ortaku emeron deri ne dy eksperte kontabel per nje periudhe kohe prej 6 vitesh financiare te cilet ushtrojne kontroll te veprintarise se shoqerise.

Ekspertet kontabel bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjykojne te nevojshme, ne cdo kohe te vitit dhe te dy bashke ose vec e vec.

Ata mund te shqyrtojne ne vend te gjithe dokumentacionet e shoqerise qe e vleresojne te dobishme ne ushtrimin e detyres se tyre.

### KREU V Veprintaria e shoqerise

#### NENI 12

Viti ekonomiko finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Viti i pare finanziar fillon ne daten e themelimit te shoqerise.

Pagimi i pagave, taksave e tatimeve dhe i kuotave per sigurimet shoqerore do te behet ne perputhje me dispozitat perkatese ne fuqi.

#### NENI 13

Shoqeria do te mbaje librin e llogarise ne leke dhe ne valute te huaj dhe do te beje perllogaritjet per nxjerjen e bilancit ne perputhje me ligjin Nr 7661 date 19.1.1993." Per kontabilitetin".

#### NENI 14

Emerimi dhe marja ne punë ,caktimi i pages per cdo punonjes dhe largimi nga puna jane kompetence e administratorit.

Maredheniet e punës mes shoqerise si punedhenese dhe punemaresve rregullohet me kontratat e punës dhe legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Maredheniet e punes mes shoqerise si punedhenese dhe punemaresve rregullohet me kontratat e punes dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

**KREU VI**  
**Prishja , shperndarja dhe likuidimi**



**NENI 15**

Shoqeria mund te shperndahet per shkaqet e meposhtme:

- a) Me mbarimin e afatit te percaktuar ne nenin 3 te ketij statuti dhe ne rast zyshimi te tij ne baze te dispozitave te ketij statuti me mbarimin e ketij afati te ri
- b) Me vendim te ortakut.
- c) Me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar, pasi te jete shpenzuar dhe fondi rezerve ne baze te nenit 72 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992."Per shoqerite tregtare"

Ne rast se ortaku nuk merr vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne rastin e prishjes se shoqerise , shoqeria do te likuidohet .

Ortaku duhet te caktoje nje ose disa likuidatore.

Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e sektionit te vetem te kreut te V te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "

**NENI 16**

Te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese qe duhet te aprovoje llogarite sociale ,keto llogari duhet te jene ne dispozion te ortakut ne seline e shoqerise.

Keshilli i administrimit do te percaktoje rregullat operative per ti bere te mundur ortakut konsultimin e librave te llogarive sociale te pakten 2 here ne vit.

**NENI 17**

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

**STATUTI**

**I SHOQERISE "BAJRAMI -N " SH.P.K  
ORTAKU I VETEM**

**Nazif Bajrami**

*Nazif Bajrami*  
*Nazif*